



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.66-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim ZL.Anr.66-4/2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZL.Anr.66/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR kërkesa për rishikim ZL.Anr.66-4/2025 e datës 30.09.2025, e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, ZL.Anr.66/2025 të datës 29.09.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 800.00 euro (tetëqind euro), dhe e ka detyruar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

Paneli me vendimin ZL.Anr.66/2025, të datës 29.09.2025, e kishte miratuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 800.00 euro (tetëqind euro), ka detyruar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, si dhe ka urdhëruar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti heq posterat e vendosur në rrugët “Bill Clinton” dhe në rrugën “Tirana”, në Prishtinë .

PZAP-i, me datë 30.09.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e vendimit ZL.Anr.66/2025, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendohet posterat e vendosur me material promovues nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës janë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore që rregullojnë fushatën dhe vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësirat publike, sepse të njëjtit kanë autorizuar kompaninë “As Studio”, në Prishtinë që në emër dhe në llogari të saj të aplikoj për marrjen e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme, si dhe të vendose materialet zgjedhore të kontraktuara. Kanë theksuar se bazuar në

këtë autorizim Kompania "As Studio", ka aplikuar në Drejtori e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, dhe është pajisur me Pëlqimin që mban numër 7.353/02144185 të datës 22.09.2025, i cili ka përcaktuar qartë vendosjen e 20 tabelave me material informues për procesin zgjedhor. Tutje, kanë shtuar se gjatë vendosjes se materialit zgjedhor janë respektuar afatet kohore, dhe kushtet teknike të përcaktuara në pëlqim. Bazuar në këto, kanë kërkuar nga PZAP që të anuloi vendimin ZL.Anr.66/2025, të datës 29.09.2025 dhe që ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se;

Kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit ZL.Anr.66/2025, të datës 29.09.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesës për rishqyrtim të datës 30.09.2025, për shqyrtimin e vendimit ZL.Anr.66/2025, të datës 29.09.2025, rrjedh se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i, nuk e ka kontestuar legjitimitetin e autorizimit ndaj kompanisë "As Studio", apo Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës.

Në këto rrethana Paneli konstatoi se në Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike nuk zëvendëson Kontratën se kjo kompani ka të lidhur kontratë me subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës ashtu që të mund të vendos tabela informuese për të. Duke marr parasysh faktin se nuk ekziston një kontratë e lidhur konkludojme se Kompania "As Studio", nuk mund të vendos postera-banera në emër të subjektit politik LDK.

Në Pëlqimin lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, nuk është përmendur se kjo kompani mund të vendos material informues zgjedhor për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu që Kompania "As Studio" nuk ka lidhur kontratë me këtë subjekt politik, prandaj, duke marrë për bazë faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e ka dëshmuar se ka lidhur një kontratë me Kompaninë "As Studio" nuk mund të merret si dëshmi e bazuar.


Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lart.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *"Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës."*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzoje si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.66-2/2025, datë 01.10.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*